

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I EDUKIMIT

FIZIK DHE I SPORTIT



PUNIM I DIPLOMËS

MASTER

TEMA

**DISA PARAMETRA MORFOLOGJIK, LËVIZOR BAZIK DHE
SPECIFIK, TE TË RINJTË E MOSHËS 14-15 VJEÇ NË
BASKETBOLL**

Mentori:

Prof. Dr. Hazir SALIHU

Kandidatja:

Lorena HAXHA

Prishtinë, 2019

Falënderime!

Kjo diplomë është rezultat i studimeve gjashtë vjeçare në Universitetin "Hasan Prishtina" në Prishtinë. Aftësitë e shprehura në këtë punim nuk do të ishin të këtij niveli pa ndihmën e të gjithë Profesorëve të Fakultetit të Shkencave Sportive, për të cilët ruaj një mirënjohje të veçantë. Në radhë të parë dua të falenderoj Allahun që na e dha mendjen e shëndoshë, pastaj familjen time, nënën dhe babain të cilët më përkrahën tërë kohën në çdo aspekt, si dhe nuk kursyen asgjë për të më arsimuar, dhe më ofruan mbështetje morale dhe financiare gjatë gjithë kohës. Mbështetje gjatë studimeve gjithashtu më ofruan motra Reimanda dhe vëllezërit Besniku dhe Albani. Një falënderim shumë special dhe gjithë mirënjohja ime i shkon udhëheqësit tim shkencor, Prof. Ass. Dr. Hazir Salihu për këshillat e panumërta e të çmueshme që më ka dhënë, për konsulencën e tij të përpiktë e profesionale, për punën e tij me të vërtet të durueshme e të palodhur lidhur me korrektimet. Falënderime të pakufishme

ABSTRAKTI

Në këtë punim si qëllim kryesor të këtij punimi ishte për të vërtetuar dallimet ndërmjet basketbollisteve dhe basketbollistëve të reja në zhvillimin morfologjik (antropometrik), motorik bazik dhe specifik. të moshës 14-15 vjeçare \pm 6 muaj.

Mostra në këtë punim ishte prej 60 basketbollistë të rinj të cilët u takojnë dy gjinive të ndryshme ndërsa për të vërtetuar qëllimin kryesorë të këtij punimi dhe qëllimet e tjera në i kemi analizuar duke e përdorur paketën matematikore SPSS për ëindoës, kemi përdorur analizën deskriptive për të interpretuar themelore statistikore për të dy grupet (vajza dhe meshkuj) veç e veç me ç'rast janë fituar disa vlera të përgjithshme specifike në hapësirën antropometrike edhe atë të motorikes bazike dhe motorikes situacionale. Analiza korrelative gjithëashtu është përdorur për të dy grupet dhe i kemi vërtetuar lidhjet dhe ndërlidhjet ndërmjet variablave nga hapësira antropometrike dhe motorike sikurse edhe ndërmjet variablave të hapësirës antropometrike dhe asaj motorike bazike dhe motorikes specifike ku kemi fituar disa korrelacione të pjesërishme ndërmjet variablave. Për të vërtetuar qëllimin kryesorë të punimit në hapësirën antropometrike, hapësirën e motorikes bazike dhe motorikes situacionale e kemi përdorur analizën e T-testit ndërmjet djemëve dhe vajzave.

Në përfundim të këtij punimi mund të konkludojmë që ky punim mund të ketë vlerën e vet të rëndësishme për vlerësimin e parametrave antropometrik të vajzave dhe djemve të cilët janë sportiest aktiv në lojën e basketbollit, si dhe dallimet ndërmjet tyre në aftësitë e motorikes bazike dhe motorikes situacionale ndërmjet vajzave dhe djemve.

Fjalët kyçe: Basketbollistet, Antropometri, motorike, T-testi

PËRMBAJTJA

ABSTRAKTI	3
1. HYRJE	6
1.1. Rëndësia e hulumtimeve të deritanishme	8
2. QËLLIMI I PUNIMIT – STUDIMIT	11
2.1. HIPOTEZAT THEMELORE.....	12
3. METODOLOGJIA E PUNËS	13
3.1 Mostra e entiteteve (të testuarve)	13
3.2 Mostra e variablave antropometrike.....	13
3.3. Mostra e variablave motorike bazike	14
3.4 Mostra e variablave motorike specifike	14
3.5. Kushtet e matjes	15
3.6 Përshkrimi i instrumenteve matëse antropometrike	16
1. Lartësia e trupit.....	16
2. Peshë e trupit	17
3. Gjatësia e krahut.....	18
4. Gjatësia e pëllëmbës së dorës.....	19
5. Gjerësia e pëllëmbës së dorës.....	20
6. Gjatësia e këmbës.....	21
7. Gjatësia e shputës së këmbës	22
8. Gjerësia e shputës së këmbës	23
3.7. Përshkrimi i instrumenteve matëse bazike dhe specifike.....	24
1. Kërcim nga vendi në gjatësi	24
2. Kërcim nga vendi në lartësi.....	25
3. Vrapim në 20 metra nga starti lart.....	26
4. Vrapim 2x20 metra nga starti lart me top	27
5. Hedhja e topit të basketbollit.....	28

6. Gjuajtje me kërcim nga 5 pozicionet 4.20m.	29
7. Gjuajtjet e lira me dorën e djathtë	30
8. Gjuajtjet e lira me dorën e majtë.	31
4. REZULTATET DHE DISKUTIMET	32
4.1. Rezultatet e matjeve antropometrike për vajzat dhe djemtë	32
4.1.1. Parametrat themelor statistikor të matjeve antropometrike, të vajzave	32
4.1.2. Parametrat themelor statistikor të matjeve të motorikes bazike dhe situacionale, të vajzave	33
4.1.3. Parametrat themelor statistikor të matjeve antropometrike, të djemve	34
4.1.4 Parametrat themelor statistikor të matjeve të motorikes bazike dhe situacionale, të djemëve	35
4.2. Rezultatet e korelacioneve për matjet antropometrike për vajzat dhe djemtë.....	36
4.2.1 Korrelacionet të matjeve antropometrike, të vajzave	36
4.2.2 Korrelacionet të matjeve të motorikes bazike dhe motorike situacionale të vajzave.....	37
4.2.3 Kroskorrelacionet të variablave antropometrike dhe motorike të vajzave.....	38
4.2.4 Korrelacionet të matjeve në hapësirën antropometrike, të djemve	39
4.2.5 Korrelacionet të matjeve të motorikes bazike dhe motorike situacionale të djemve	40
4.2.6. Kroskorrelacionet të variablave antropometrike dhe motorike të djemve	41
4.3. DALLIMET NDËRMJET GRUPIT TË DJEMVE DHE VAJZAVE	42
4.3.1. T- Testi ndërmjet grupit të djemve dhe vajzave në hapësirën antropometrike	42
4.3.2. T- T- Testi ndërmjet grupit të djemve dhe vajzave në hapësirën lëvizore bazike dhe specifike	43
5. VËRTETIMI I HIPOTEZAVE.....	44
6. PËRFUNDIMI	45
7. BIBLIOGRAFIA	47
8. <i>PARAQITJA GRAFIKE E VARIABLAVE ANTROPOMETRIKE DHE MOTORIKE</i>	49
8.1. Paraqitja grafike e variablave antropometrike të djemve dhe vajzave	49
8.2. Paraqitja grafike e variablave motorike të djemve dhe vajzave	53

1. HYRJE

Basketbolli është një nga sportet e njohura dhe atraktive nga çdo moshë dhe gjithashtu e pranuar nga dy gjinitë si vajzat ashtu dhe djemtë.

Basketbolli është një sport që kërkon shkathtësi dhe lëvizje të ndryshme duke e cekur se nuk është nga sportet e buta por është mjaftë sport luftarak dhe kërkon kondicion të bollshëm.

Të gjithë sportistët gjithashtu dhe individët e thjeshtë e dinë se cilat janë trielementet kryesore të basketbollit si: Driblimi, Pasimi dhe Gjuajtja në kosh, pra të kenë një dominim të aftësive motorike si aksioni dhe reaksioni.

Që nga ekzistenca e lojës së basketbollit deri më sot shumë trenera dhe faktorë që kanë dashur ta avancojnë këtë sport kanë luftuar të kenë sa më shumë hulumtime dhe gjetje të cilat do ta dërgonin sportin e basketbollit përpara, duke cekur dhe sot nuk kanë të ndalur dhe ka arritur mjaft maja ky sport duke mos e anashkuar kërkimin e talenteve të riinjë të cilët e kompletojnë këtë sport.

Basketbolli bashkëkohor përbën kompleksitet të madh dhe variabilitet të punëve motorike gjatë lojës të cilat janë të orientuara në arritjen sa më të madhe të tempos, dinamikës dhe atraktivitetit, zhvillimit optimal të personalitetit të lojtarit e me këtë edhe në sukseset sportive në gara.

Suksesi në basketboll është i mundur vetëm atëherë nëse në mënyrë sistematike definoen fenomenet të cilat janë të një rëndësie të veçantë primare për strukturimin e lëvizjeve themelore në lojën e basketbollit, ligjshmëritë e transformimeve orientuese dhe gjeneratorët primar të aktiviteteve sportive.

Zhvillimi bashkëkohor i sportit gjithnjë e më tepër bazohet në hulumtimet shkencore dhe qëndrimin kibernetike në modelimin e proceseve të treningut sportiv.

Qëndrimi i tillë kërkon zbulimin e ligjshmërive dhe lidhjeve ndërmjet fushave të ndryshme të statusit psikosomatik të cilat janë përgjegjëse ose veprojnë në ekzekutimin të detyrave të ndryshme motorike në sporte.

Në kohën e sotme, niveli i arritjes në sportin kulmor aq është i lartë sa që sportistët gjatë sistemeve të përgatitjes stërvitore mund të arrijnë ose ti tejkalojnë vetëm me anë të ngritjes më të madhe të efikasitetit stërvitor. Mirëpo rritja e efikasitetit supozohet jo vetëm rritja e sasisë sëpunës, por në rend të parë organizimin më të mirë të procesit stërvitor, zgjedhja më e mirë e mjeteve dhe metodave, renditja më racionale e punës dhe çlodhjes gjatë një procesi stërvitor, disa proceseve stërvitore,

etapave dhe periudhave, dhe e gjithë kjo pandërprerë duke u kujdesur për gjendjen e sportistit. Këto kërkesa mund të realizohen kryesisht gjatë udhëheqjes (kibernetike) optimale me proceset gjithëpërfshirëse pedagogjike në proceset stërvitore sportive.

Për ta kuptuar më mirë dhe më lehtë qëndrimin kibernetike të procesit stërvitor në lojën e basketbollit, këtë mund ta bëjmë me rastin e analizimit të aktiviteteve sportive. Ekziston mundësia që të bëhet klasifikimi i caktuar i sporteve, me ndihmën e së cilave të gjitha sportet mund ti ndajmë në numër të caktuar të grupeve të ngjashëm (të përafërta), pasi që ligjshmëritë që vlejné për një grup të aktiviteteve të ngjashëm ose të përafërta nuk do të thotë domosdo se duhet të vlejné për grupin tjetër.

Basketbolli si sport numërohet në grupin e sporteve kolektive, kurse sipas lëvizjeve bien në grupin e sporteve shume strukturale të aktiviteteve komplekse, i cili dallohet me lëvizje ciklike dhe aciklike. Është sporti shumë i popullarizuar në botë, kjo del nga prania, dinamikës, emocionaliteti dhe atraktiviteti si dhe shumë lëvizjeve të përbëra tekniko-taktike të cilët ndodhin në të gjitha pjesët e fushës.

Gjatë aktiviteteve garuese përgatitja kondicionalë, teknike, taktike si dhe fushat tjera të përgatitjes së basketbollistëve paraqesin tërësinë e ndërlikuar dhe integrale dhe asnjëherë nuk shprehen ndarazi. Çdo ose të gjitha drejtimet e përmendura të përgatitjes sportive në një masë varen nga niveli dhe struktura e drejtimeve tjera të përgatitjes së sportistëve, dhe në këtë mënyrë së bashku ndikojnë në arritjen e rezultateve maksimale kulmore. Kështu për shembull, përgatitja teknike e sportistëve në sportin e basketbollit në masë të madhe varet nga shkalla aftësitë funksionale dhe motorike. Me fjalë të tjera është e pamundur që basketbollistin në mënyrë kualitative ta përgatisim në pikëpamje teknike nëse ai nuk posedon aftësi motorike të cilat janë të domosdoshme për realizimin e elementeve teknike të theksuara gjatë lojës, siç janë për shembull, forca, shpejtësia, kordinacioni, fleksibiliteti qëndrueshmëria e tjera.

1.1. Rëndësia e hulumtimeve të deritanishme

Në kuadër të këtij punimi dhe në fushën e trajtimit në aspektin eksperimental në hapësirën e antropometrisë dhe motorikes kemi hulumtuar një numër të madh të punimeve shkencore dhe punimeve tjera të cilat i kemi përdorur si bazë të hulumtimeve të deritanishme. Për të zhvilluar këtë punim do të analizojmë disa nga punimet e lëmisë së basketbollit dhe ngjashëm të autorëve vendor dhe ndërkombëtar. Ndër autorët të cilët janë marrë me këto hulumtime janë:

Hazir Salihu, në vitin 2003, në disertacionin e tij të doktoratës “Ndryshimet e zhvillimit të veçorive morfologjike dhe aftësive motorike të basketbollistët e rinj” Ai në studimin e tij ka përfshirë mostrën prej 161 basketbollistëve të moshës 16 vjeç, në testimin fillestar dhe përfundimtar. Në hapësirën antropometrike ka përfshirë 11- teste, ndërsa në hapësirën motorikes ka përfshirë 12 teste në motorike bazike dhe situacionale, është bërë testimi fillestar dhe përfundimtar për të gjithë basketbollistët. Autori nga ky punim në hapësirën antropometrike i ka fituar tre faktorë, ndërsa tek hapësira e testeve të motorikes, ato bazike dhe situacionale, ka fituar 4 faktorë me rëndësi të vlefshme .

M.Aliu (1991), në disertacionin e doktoratës me temën: „Zhvillimi morfologjik dhe disa karakteristika motorike të popullatës dhe diferenca në ato karakteristika kronologjike të moshës së caktuar“, mostra prej 461 të testuarve ka qenë ndarë në tri submostra (15, 16 dhe 17 vjeçare) në bazë të rezultateve të faktorizimit në hapësirën antropometrike janë izoluar tre dimensione latente antropometrike: dimensionin i skeletit cirkular, indi dhjamor nënlëkuror dhe dimensionin i skeletit transversal, ndërsa në hapësirën latente antropometrike, për submostrën 17 vjeçare, janë ekstraktuar 3 faktorë latentë lëvizorë të definuar si: 1. faktori i ekuilibrit me sy të mbyllur dhe të hapur, 2. faktori i sprintit dhe 3. faktori i forcës eksplozive

H.Rushiti (1999), në punimin e tij të magjistraturës “Struktura faktoriale e dimensioneve antropometrike dhe relacioni i tyre me disa aftësi motorike të rinjtë e moshës 13-14 vjeçare”¹, në mostrën prej 205 nxënësve të moshës 13-14 vjeçare , nxënës të shkollave fillore që janë trajtuar me 18 variabla antropometrike dhe 11variablave motorike, me faktorizimin e hapësirës antropometrike ekstraktoi 2 faktorë latentë antropometrikë: faktorin gjeneral morfologjik dhe faktorin e indit dhjamor nënlëkuror.

Ndërsa në hapësirën lëvizore janë ekstraktuar tre faktorë latentë lëvizorë: 1.faktori i fleksibilitetit të trupit, 2.faktori i forcës dhe shpejtësisë dhe 3.faktori i shpejtësisë së frekuencave të dorës dhe kërcimit së gjati nga vendi

S. Sekereš (2000), në punimin e tij ka arritur të vërteton se forca në sporte veçanërisht në basketboll manifestohet përmes katër formave dhe atë: forca absolute, forca e shpejtësisë, forca eksplozive dhe qëndrueshmëria në forcë. Forca eksplozive është njëri ndër aftësitë më të rëndësishme motorike për basketbollistët kulminant

Salihu. H (2000), në punimin e magistraturës, ka testuar relacionet e disa karakteristikave trupore dhe aftësive motorike, bazike situacionale tek basketbollistët e moshës 14+ 6 muaj. Si model(mostër) e këtij punimi i cili përfshin 108 basketbollistë të rinj të gjinisë mashkullore, të qytetit të Prishtinës, ku për model të ndryshoreve ka morfologjinë dhe ka aplikuar 10 teste, dhe aftësive motorike situacionale (5) teste, dhe (5) teste tjera nga aftësitë motorike të përgjithshme apo bazike.

Balla (1980), ka hulumtuar dimensionet lëvizore te femrat dhe meshkujt. Nëmostrën prej 3102 nxënësve te të dy gjinitë, të moshës 6-10 vjeç, nga shkollat fillore tëzonave urbane të Krahinës Autonome të Vojvodinës, në bazë të njëmbëdhjetë testevelëvizore, me anë të analizës faktoriale ka vërtetuar dimensionet lëvizore te meshkujt dhe te femrat te të gjitha moshat. Bazuar në rezultatet e analizës faktoriale të hapësirës lëvizore, autori arriti në përfundimin se ka të bëjë vetëm me një dimension të përgjithshëm gjeneral, për shkak se nuk janë të izoluara dimensionet specifike lëvizore. Kjo tregon se nëniveli të sistemit nervor qendror nuk kemi diferencim të qartë të qendrave lëvizore.

Gabrijelic.M., me (1977) ka hulumtuar, në mostrën prej 222 sportistëve kulminantëtë rangut federativ, të moshës 18-25 vjeç, anëtar të kategorisë së sporteve mashkullore, basketboll (54), futboll (52), volejbol (58), hendboll (58), lindshmëria e dimensioneve manifeste latente, të përgjithshme dhe specifike motorike, kognitive dhe konative mesukses në secilën lojë sportive posaçërisht, atë e ka bërë analizën komparative të lojëraesportive. Janë përdorur 16 teste universale në të gjitha grupet e të testuarve, dhe atë ngatre teste specifike situacionale për secilën lojë sportive. Aftësitë e basketbollistëve kulminant në krahasim me sportet tjera janë renditur si në vazhdim : Basketbollistët janë superior në forcën eksplozive të këmbëve dhe duarve, kurse më inferior në shpejtësinë evrapimit. Përveç kësaj të gjitha dimensionet manifestuese të neurotizmit gjeneral të basketbollistëve janë më së paku të shprehura në raport me tri lojërat tjera sportive.

Masar Nixha (1985). Në disertacionin e tij me temën “Analiza e karakteristikave trupore dhe aftësive motorike të basketbollistëve të niveleve të ndryshme garuese, dhe analiza komparative me hendbollistë dhe volejbollistë”. Kishte një mostër me lojtarët e tri ekipeve të para të të tri rangjeve, ku i kishte trajtura me 11 variabla variabla antropometrike dhe 7 variabla motorike. Pas këtyre analizave ka ardhë në përfundim, se lojtarët e tre sporteve nuk dallohen shumë në mes veti në karakteristikat trupore. Dallimet kanë qenë të pritura sepse basketbollistët kanë qenë më të gjatë, ndërsa hendbollistët kanë pasur vlera më të larta në peshë dhe në perimetra, ndërsa volejbollistët indin dhjamorë. Në karakteristikat e statusi lëvizor, basketbollistët kanë pasur vlera më të larta në agjilitet, hendbollistët në forcë dinamike, dhe volejbollistët në forcë eksplozive.

2. QËLLIMI I PUNIMIT – STUDIMIT

Studime të shumta shkencore, sidomos në vitet e fundit, kanë identifikuar dhe shpjeguar rëndësinë e jashtëzakonshme të ndikimit të faktorëve të ndryshëm antropologjik që përcaktojnë në masë të madhe suksesin e në lojën e basketbollit. Arritjet sportive kulmore në lojën e basketbollit mund të arrihen vetëm duke i njohur të gjithë këta faktorë nga të cilët varet suksesi në lojën e basketbollit. Duke u nisur nga ky fakt dhe fakti se çdo moshë i ka specifikat e veta, parashtrohet edhe qëllimi i punimit.

Qëllimi kryesor i parashtruar në këtë projekt të këtij punimi është të vërtetohet dallimi në mes basketbollistëve dhe basketbollistëve të reja në zhvillimin morfologjik (antropometrik), motorik bazik dhe specifik.

Qëllimi dytësor do të jetë:

1. Vërtetimi i koeficientëve të asimetrisë të variablave antropometrike, motorike bazike dhe specifike te basketbollistët dhe basketbollistët e reja.
2. Vërtetimi i koeficientëve të korelacionit të variablat antropometrike, motorik bazik dhe specifik te basketbollistët dhe basketbollistët e reja..
3. Vërtetimi i lartësisë statistikore të dallimeve në variablat antropometrike, motorike bazike dhe specifike te basketbollistët dhe basketbollistët e reja.

2.1. HIPOTEZAT THEMELORE

Me qëllim të vërtetimit të saktë dhe shkencorë të variablave të hulumtuara dhe objektivave primare janë paraparë këto hipoteza :

1. H1:Supozojmë se variablat antropometrike, bazike motorike dhe specifike te basketbollistët e dy gjinive nuk do të kenë koeficient me asimetri të theksuar.
2. H2:Supozojmë se koeficientet e fituar të korelacionit të variablave antropometrik, bazike motorike dhe specifike te basketbollistët e dy gjinive do të jenë në korelacion në mes veti.
3. H3:Supozojmë se në mes basketbollistët e dy gjinive do të ketë dallime të rëndësishme në variablat antropometrike, bazike motorike dhe specifike.

3. METODOLOGJIA E PUNËS

3.1 Mostra e entiteteve (të testuarve)

Në këtë projekt do të trajtohen basketbollistët e rinjë të moshës 14-15 vjeç, ku numri i përgjithshëm do të jetë nga 60 basketbollistë të rinj të cilët u takojnë dy gjinive të ndryshme.

Grupi I – do të përbëhet prej 30 basketbollisteve të reja, pra gjysma e mostrës së këtij hulumtimi të cilët janë të moshës 14-15 vjeç të ekipit të basketbollit “KB TREPÇA” pjesëmarrës në Ligën e Kosovës për kategoritë të reja gjatë sezonit 2018/2019.

Grupi II - do të përbëhet po ashtu prej 30 basketbollistëve të rinjë dhe gjysma tjetër e mostrës, të cilët i takojnë moshës përkatëse 14-15 vjeç të ekipit të “KB TREPÇA” gjithashtu pjesëmarrës në Ligën e Kosovës për kategori të reja gjatë sezonit 2018/2019.

3.2 Mostra e variablave antropometrike

Mostra e basketbollistëve të rinjë në këtë projekt i janë nënshtruar procedurave të testimit në kushte të njëjta, para fillimit të orës stërvitore për të katër ekipet. Grupin e parë të ndryshoreve e përbëjnë ndryshoret antropometrike dhe testet e aftësive lëvizore të karakterit bazik, ndërsa grupin e dytë e përbëjnë ndryshoret situacionale tipike të lojës

së basketbollit:

1. ALARTE - Lartësia e trupit
2. APESHA - Peshë e trupit
3. AGJKTKR - Gjatësia e krahut
4. AGJAPDO - Gjatësia e pëllëmbës së dorës
5. AGJESH - Gjerësia e pëllëmbës së dorës

6. AGJATKËM - Gjatësia e këmbës
7. AGJATSHP - Gjatësia e shputës së këmbës
8. AGJESHK - Gjerësia e shputës së këmbës

3.3. Mostra e variablave motorike bazike

Për vlerësimin e aftësive lëvizore bazike janë përfshirë këto ndryshore:

1. MKVGJ– Kërcim nga vendi në gjatësi
2. MKVL – Kërcim nga vendi në lartësi
3. MV20MSL – Vrapim në 20 metra nga starti lartë
4. MV2X20MT – Vrapim 2x20 metra nga starti lartë me top
5. MHTBAS – Hedhja e topit të basketbollit

3.4 Mostra e variablave motorike specifike

Për vlerësimin e aftësive lëvizore specifike janë përfshirë këto ndryshore:

1. GJ5POZ – Gjuajtje me kërcim nga 5 pozicionet 4.20m
2. GJLDD – Gjuajtjet e lira me dorën e djathtë
3. GJLDM - Gjuajtjet e lira me dorën e majtë

3.5. Kushtet e matjes

1. Matjet antropometrike janë realizuar në orët e para të paradites.
2. Instrumentet matëse të punimit kanë qenë të vazhduara, standarde dhe valide.
3. endi ku janë ekzekutuar matjet ka qenë hapësirë e mjaftueshme dhe e ndriçuar mirë.
4. Në vendin ku janë ekzekutuar matjet (palestër sportive) kanë qenë pesë matës, shkruesi i rezultateve dhe grupi prej pesë të testuarve të cilët janë zëvendësuar pas matjes.
5. Të testuarit para matjes kanë qenë zbathur dhe me veshje të lehta sportive.
6. Te çdo i testuar, para matjes janë përcaktuar dhe shënuar në mënyrë të saktë nivelet dhe pikat antropometrike të cilat kanë qenë në programin e matjeve.
7. Dimensionet e caktuara antropometrike çdo herë i ka matur i njëjti testues. Rezultatet e matjes janë lexuar gjatë kohës deri sa i testuari është matur, ndërsa personi i cili ka shkruar rezultatet për t'i kontrolluar i ka përsëritur rezultatet me zë të qartë.
8. Matjet e segmenteve çift të trupit janë ekzekutuar në anën e majtë të trupit.
9. Matjet antropometrike janë përsëritur nga tri herë.

3.6 Përshkrimi i instrumenteve matëse antropometrike

1. Lartësia e trupit

Për të matur lartësinë e trupit është përdorur metri. Nxënësit gjatë realizimit të matjeve kanë qenë të zbathur me veshje sportive, ata kanë qëndruar në këmbë paralel në bazën e fortë horizontale.

Nxënësit duhet drejtuar shpinën aq sa është e mundur, qëndrimi i trupit duhet të jetë i drejtë dhe shputat e bashkuara. Profesori që bënë matjen qëndron afër të maturit dhe e kontrollon se a është vënë në mënyrë të rregullt metri për matjen e nxënësit që është horizontalisht derisa ta prek kokën e të maturit. Rezultati lexohet prej 0.1cm.



Fig.1

2. Pesha e trupit

Pesha e trupit është matur me peshoren me sustë e cila mundëson saktësinë e matjes prej 0.1 kg, treguesi rregullohet në pozitën zero. E domosdoshme është që peshorja të vihet në pozitë horizontale. Nxënësi është i zbathur, me veshje të lehta sportive, qëndron i qetë, në këmbë në mes të peshores. Pasi që treguesi në peshore të qetësohet, rezultati lexohet me saktësi prej 0.1. kg.. me saktësi prej 0.1 kg..



Fig.2

3. Gjatësia e krahut

Për të matur gjatësinë e krahut kemi përdorur metrin. Nxënësi ka qëndruar në këmbë, me trup të drejtë, dora është e shtrirë. Njëri skaj i metrit vendoset në majë të gishtit të mesëm të dorës së majtë, kurse tjetri skaj (aty ku lexohet rezultati) në zgjatimin shpatullor (processus acromialis) të anës së njëjtë. Rezultati lexohet me saktësi 0.1 cm.



Fig.3

4. Gjatësia e pëllëmbës së dorës

Gjatësia e shuplakës së dorës matet me metër, nxënësi qëndron me krahun e majtë të shtrirë mbi gjurin e majtë. Dora e majtë duhet në bërryl të jetë në fleksion 90 (shkallë) dhe me gishtërinj të mbledhur dhe të shtrirë horizontalisht. Hapet dora dhe metri vendoset në të dy skajet e dorës për së gjati, rezultati lexohet sakt prej 0.1cm.



Fig.4

5. Gjerësia e pëllëmbës së dorës

Gjerësia e shuplakë së dorës matet me metër, nxënësi qëndron me dorën e majtë në pozitë të njëjtë me pozitën gjatë matjes së diametrit të nyjetimit të dorës, (me dorën e majtë mbështetur në bërryl në kënd të drejtë dhe me gishtërinj të drejtuar e të ofruar). Krahët instrumentit matës vendosen lateralisht në ashtin e dytë dhe të pestë metakarpal (pika metakarpale radiale dhe ulnare), rezultati lexohet me saktësi 0.1 cm.



Fig.5

6. Gjatësia e këmbës

Gjatësia e këmbës është matur me metër. Nxënësi duhet të qëndrojë sikurse në matjen e lartësisë së trupit. Realizimi i matjes është bërë në dysheme ku qëndron nxënësi i zbathur deri në pikën e cila caktohet me gishtin e mesëm të dorës që mban pjesën horizontale të metrit. Rezultati lexohet saktë 0.1cm.



Fig.6

7.Gjatësia e shputës së këmbës

Është matur me metër, nxënësi ka qëndruar në pozitë të drejtë me baraspeshim të dy këmbët, me shputa të vendosura paralel dhe për një gjerësi të shputës të ndarë njëranga tjetra. Matja është bërë nga lart (ana dorëzale) aty ku është gjerësia më e madhe. Saktësia e matjes ka qenë 0.1 cm.



Fig.7

8.Gjerësia e shputës së këmbës

Është matur me metër, nxënësi ka qëndruar në pozitë të drejtë me baraspeshim në të dy këmbët, me shputa të vendosura paralel dhe për një gjerësi të shputës të ndarë njëra nga tjetra. Matja është bërë nga lart (ana dorëzale) krahet e kompasit janë vendosur në pjesën metatarzale të shputës, aty ku është gjerësia më e madhe. Saktësia e matjes ka qenë 0.1 cm.



Fig.8

3.7. Përshkrimi i instrumenteve matëse bazike dhe specifike

1.Kërcim nga vendi në gjatësi

Për të vlerësuar aftësitë motorike kemi realizuar edhe testin e forcës eksplozive atë të kërcimit së gjati nga vendi. Ky test është realizuar duke bërë shpëputje nga vendi me të dy këmbët. Nxënësve u lejohej të lëvizin me duar, ndërsa këmbët vendosen mbrapa vijës së kërcimit, testi i kërcimit së gjati realizohet duke përdorur forcë maksimale. Gjatësia e kërcimit së gjati është matur me cm, pra distanca në mes të vijës së kërcimit dhe asaj ku prek thembra në vijë, prej tri tentimesh shënohet rezultati më i favorshëm prej 0.1cm



Fig.9

2.Kërcim nga vendi në lartësi

I testuari qëndron afër metrit brinjazi, me krahun e djathtë të ngritur lartë dhe duke i mbështetur gishtërinjtë e dorës në mur. Shkëputja kryhet nga vendi me të dy këmbët. Janë të lejuara lëvizjet e hovit me duar, dhe ngritja në gishtërinj të këmbëve para shkëputjes. Shkëputja e dyfishtë nuk është e lejuar. I testuari kërcen sa më lartë që mundet me të dy këmbët dhe rënien duhet ta bëjë me të dy këmbët, ekzekutohen dy deri në tri kërcime. Gjatësia e kërcimit matet nga distanca kur nxënësi prek pikën më të lartë me dorë e cila arrihet pas shkëputjes maksimale në pjesën e majeve të gishtërinjve. Vlen rezultati i kërcimit më të gjatë i cili shënohet në centimetra.



Fig.10

3.Vrapim në 20 metra nga starti lart

Me këtë test është vlerësuar aftësia e shpejtësisë së vrapimit.Nxënësi qëndron me të dy këmbët pas vijës së startit, në pozicionin starti i lartë.Matësi jep komandën “gati” (pas së cilës subjekti përkulet para, me peshën në këmbën e përparme) dhe “tani” pas së cilës nxënësi fillon vrapimin dhe tenton që maksimalisht shpejtë të vrapojë në distancën 20 m. Në momentin kur startuesi jep komandën “tani”,duke lëshuar dorën prej pozitës horizontale – poshtë, matësi i kohës e nis matjen me kronometër dhe e ndalë atë kur subjekti e kalon me gjoks vijën e cakut.

Matet koha prej startit deri te caku dhe rezultati i fituar shënohet në fletë testin përkatës me saktësi 0.10sec.



Fig.11

4.Vrapim 2x20 metra nga starti lart me top

Testi i vrapimit dy herë nga 20 metra starti i lartë dhe me udhëheqje të topit me vajtje ardhje realizohet në fushën e basketbollit, për të realizuar këtë test janë përdorur mjetet si: topi, kronometri, kona për shënimin e startit dhe cakut. Nxënësi nga pozita fillestare qëndron me të dy këmbët pas vijës së startit, në pozicionin starti i lartë. Pas komandës “tani” fillon vrapimi duke e udhëhequr topin deri në vijën e shënuar tek 20 metërshi dhe kthehet me shpejtësi maksimale, nga momenti i komandës “tani” fillon matja e kohës me kronometër derisa i testuari e kalon vajtjen dhe ardhjen me udhëheqjen e topit. Rezultati shënohet saktë 0.1sec.



Fig.12

5.Hedhja e topit të basketbollit

Me këtë test është vlerësuar forca eksplozive e gjymtyrëve të sipërme, nxënësi vendoset në qëndrim basketbollisti (paralel), me fytyrë nga drejtimi i hedhjes. Nxënësi mban topin në duar para gjoksit, realizon hedhjen e topit para vetëm me lëvizjen e krahëve, nxënësi detyrën e përsërit dy herë ndërkaq shënohet rezultati më i mirë.Shënohet vendi më i gjatë i hedhjes nësaktësi 5cm. Hedhja përsëritet në rast se i testuari nuk i përmbahet udhëzimeve të dhëna, ose në rastin e hedhjes së topit me një dorë, ose me vrull mbrapakokës.



Fig.13

6.Gjuajtje me kërcim nga 5 pozicionet 4.20m.

Gjuajtjet me kërcim në kosh nga pozicionet të ndryshme 5 prej tyre në largësinë 4.20m bëhet në këtë mënyrë, nxënësin e vendosim në hapësirën ose vijën në distancë 4.20m për gjuajtje të saktë në kosh, numri i gjuajtjeve bëhet nga 5 herë dhe praktika e gjuajtjeve bëhet në vende të ndryshme rreth hapësirës për gjuajtje nga 4.20m, për shënimet e sakta mirët rezultati më i mirë.



Fig.14

7.Gjuajtjet e lira me dorën e djathtë

Me këtë test matim precizitetin e gjuajtjeve për një pikë me dorën e djathtë nxënësi ciliekzekuton gjuajtjet duhet të qëndroj në hapësirën brenda 6.75m, nxënësi merr topin ngandihmësi dhe fillon gjuajtjet një pas një. Nxënësi kryen kështu tri gjuajtje. Gjuajtjet duhet të ekzekutohen sipas rregullave në lojën e basketbollit, kohëzgjatja e ekzekutimit të ushtrimit nuk është e kufizuar. Numërohen shënimet e sakta nga pozita e cekur dhe rezultati i arritur shënohet në fletë testimin përkatës.



Fig.15

8.Gjuajtjet e lira me dorën e majtë.

Me këtë test matim precizitetin e gjuajtjeve për një pikë me dorën e majtë nxënësi ciliekzekuton gjuajtjet duhet të qëndroj në hapësirën brenda 6.75m, nxënësi merr topin ngandihmësi dhe fillon gjuajtjet një pas një. Nxënësi kryen kështu tri gjuajtje. Gjuajtjet duhet të ekzekutohen sipas rregullave në lojën e basketbollit, kohëzgjatja e ekzekutimit të ushtrimit nuk është e kufizuar. Numërohen shënimet e sakta nga pozita e cekur dhe rezultati i arritur shënohet në fletë testimin përkatës



Fig.16

4. REZULTATET DHE DISKUTIMET

4.1. Rezultatet e matjeve antropometrike për vajzat dhe djemtë

4.1.1. Parametrat themelor statistikor të matjeve antropometrike, të vajzave

